




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Goran Rakić, Zëvendëskryeministër dhe Ministër në MPL Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqës e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 26.01.2021 Nr.020-241/21
Zyrtaret përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Sanije Dërguti, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Lipjanit	
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:


Vendimin 15Nr.463-4331 për pezullim të vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për varrezat në fshatin Rubofc 15Nr.463-14826 të datës 04.03.2019

I miratuar më datë: 19.01.2021

I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 20.01.2021

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Za:	Imri Ahmeti, gradonačelnik opštine Lipljan Daut Azemi, predsedavajući Skupštine opštine Lipljan	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumentavije u MLS-u Jedinica za administraciju dokumentacije u opštini	
Preko:	Goran Rakić, zamenik premijera i ministar MLS-a, Trim Berisha, zamenik generalnog sekretara u MLS-u,	
Od:	Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja monitorisanje opština, MLS	Dana, . 26.01.2021. Br.241-21
Službenik za utvrđivanje zakonske procene :	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština	
Službenik-ca izradu za zakonske procene:	Sanije Dërguti, viša službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Lipljan	
Vrsta akta:	Pravilnik opštine Lipljan	

Uvaženi gradonačelnice,
Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa Uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 06/2020 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MLS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku :

Odluka 15br.463-4331 o ukidanju odluke za davanje na korišćenje opštinske imovine Savetu islamske zajednice u Lipljanu za groblja u selu Rubofc 15br.463-14826 o dana, 4.03.2019. godine
Usvojena dana, 19.01.2021.
Predložena za razmatranje u MLS-u dana, 20.01.2021.

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt iz proceduralnog aspekta u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni efekat.

Ministartstvo lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12,14 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 9, 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Shkresës përcjellëse të MAPL-së Nr.020-241/16 të datës 18.04.2019 si dhe Njoftimit : Rivlerësimi i Grantit të Performancës Komunale të Ministrisë së Pushtetit Lokal Nr.454-666/11 të datës 28.12.2020, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 19. 01.2021, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

PËR PEZULLIMIN TË VENDIMIT PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR VARREZA NË FSHATIN RUBOFC 15NR.463-14826 I DATËS 04.03.2019

I. PEZULLOHET, Vendimi i Kuvendit të Komunës për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për Varreza në fshatin Rubofc 15Nr.463-14826 i datës 04.03.2019.

II. Vendimi i cekur pezullohet deri në përfundimin e procedurës gjyqësore të inicuar nga pala paditëse përkitazi me pronën komunale të dhënë në shfrytëzim sipas Vendimit të cekur në pikën I të këtij Vendimi.

III. Pas përfundimit të arsyeve që kanë shkaktuar pezullimin e zbatimit të Vendimit i njëjti do të miratohet në njërin nga seancat e ardhëshme të Kuvendit të Komunës i harmonizuar edhe me rekomandimet e cekura në Shkresën përcjellëse të MAPL-së dhe legjislacionin në fuqi.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës-Spektori Pronësor Juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës

15Nr. 463 - 4331

Lipjan, më 19. 01. 2021

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

Na osnovu člana 12,14 i 17 Zakona o Lokalnoj Samoupravi br.03/L-040, Službena Novina Republike Kosova, Br. 28 dt. 4 Juni 2008, član 9, 17 i 20 Statuta Opštine 1 Br.110-623 dt. 26.09.2008, Potpratno pismo MAPL Br.020-241/16 dt. 18.04.2019 kao i Obaveštenje: Ponovna procena opštinske Grande Performance Ministarstva Lokalne Uprave Br.454-666/11 dt. 28.12.2020, Skupština Opština na održanoj sednici dana 19.01.2021, nakon razmatranja predlog Odluke Predsednika Opštine usvojio:

ODLUKA

**O OBUSTAVLJANJU ODLUKE O DODELI UPOTREBE OPŠTINSKE IMOVINE SAVETU ISLAMSKJE ZAJEDNICE U LIPLJANU ZA GROBLJA U SELU RUBOFC 15BR.463-14826 I
DATUM 04.03.2019**

- I. OBUSTAVLJA, Odluka Skupštine opštine za davanje na korišćenje opštinske imovine Savetu Islamske zajednice u Lipljanu za groblje u selu Rubofc 15Br.463-14826 dt. 04.03.2019.
- II. Navedena odluka se obustavlja do okončanja sudskog procedura koji je tužilac pokrenuo u vezi sa opštinskom imovinom koja je data na korišćenje prema odluci pomenutoj u tački I ove odluke.
- III. Po završetku razloga koji su prouzrokovali suspenziju sprovođenja Odluke, ista će biti odobrena na jednoj od narednih sednica Skupštine opštine, usklađena sa preporukama navedenim u propratnom pismu MAPL i važećim zakonima.
- IV. O sprovođenju ove Odluke staraće se Kancelarija Predsednika-Sektor pravne imovine, Direktorati za Planiranje, Urbanizam i Zaštitu Sredine i Direktorat za Geodeziju i Katastar.
- V. Odluka stupa na snagu 7 dana nakon objavljivanja na elektronski web Opština.

Br.15- 463-433/
Lipljan 19.01.2021

SKUPŠTINA OPŠTINE LIPLJAN

Predsedavajući Skupštine





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 40 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të nenit 12,14 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 9, 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Shkresës përcjellëse të MAPL-së Nr.020-241/16 të datës 18.04.2019 si dhe Njoftimit : Rivlerësimi i Grantit të Performancës Komunale të Ministrisë së Pushtetit Lokal Nr.454-666/11 të datës 28.12.2020, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me datë ____ 2021, të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR PEZULLIMIN TË VENDIMIT PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR VARREZA NË FSHATIN RUBOFC 15NR.463-14826 I DATËS 04.03.2019

I. PEZULLOHET, Vendimi i Kuvendit të Komunës për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për Varreza në fshatin Rubofc 15Nr.463-14826 i datës 04.03.2019.

II. Vendimi i cekur pezullohet deri në përfundimin e procedurës gjyqësore të inicuar nga pala paditëse përkitazi me pronën komunale të dhënë në shfrytëzim sipas Vendimit të cekur në pikën I të këtij Vendimi.

III. Pas përfundimit të arsyeve që kanë shkaktuar pezullimin e zbatimit të Vendimit i njëjti do të miratohet në njërin nga seancat e ardhëshme të Kuvendit të Komunës i harmonizuar edhe me rekomandimet e cekura në Shkresën përcjellëse të MAPL-së dhe legjislacionin në fuqi.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës-Sektori Pronësor Juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij propozim-vendimi është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008.

Arsyet e pezullimit të Vendimi të cekur janë si vijon:

Me datë 18.04.2019, kemi pranuar shkresën e MAPL-së Nr.020-241/16 të datës 18.04.2019 për rishqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit nr. 15Nr.463-14826, për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për varreza në fshatin Rubovc me arsyetim se i njëjti është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi të cilin akt e kemi kundërshtuar përmes shkresave.

Vendimi i lartëcekur është miratuar në Kuvendin e Komunës me datë 28.02.2019 ndërsa është parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë 06.03.2019.

Nga dita e parashtrimit për shqyrtim në MAPL të aktit të cekur deri në ditën e pranimit të kësaj shkrese nga ana e Komunës kanë kaluar gjithsej 43 (katërdhjetë e tri) ditë përkatësisht prej datës 06.03.2019 deri me datë 18.04.2019.

Pavarësisht se kemi kundërshtuar me arsye Shkresën e MAPL-së pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi për pronën e cekur është hapur edhe një kontest gjyqësor nga pala paditëse.

Shfuqizimi i Vendimit të cekur në këtë periudë bëhet pasi me datë 28.12.2020 Ministri i Ministrisë së Pushtetit Lokal i ka dërguar Kryetarit të Komunës Njoftimin për Rivlerësimin e Grantit të Performancës Komunale me të cilin është vendosur që t'iu mundësohet Komunave një afat shtesë për plotësimin e kushtit minimal 2 që nënkupton "Komunat duhet të kenë respektuar obligimin ligjor për t'i rishikuar aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga organet mbikqyrëse"

Në Njoftimin e cekur gjithashtu theksohet se Komunat të cilat deri me datën 22 janar 2021 rishikojnë aktet e vitit 2019 që konsiderohen të kundërligjshme nga autoriteti mbikqyrës do të konsiderohet se kanë përmbushur kushtin minimal 2.

Duke u bazuar në faktin se lënda përkitazi me pronën komunale gjendet në procedurë gjyqësore dhe duke u bazuar në nevojën e Komunës për mbështetje financiare pasi Granti i performances Komunale është një nga skemat kryesore të mbështetjes së qeverisjes lokale, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 463-630
Lipjan, më 06-01/2021





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 10 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, nenit 20 paragrafi 3 pika 3.3 të Rregullores QRK Nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr. 110-623 të dt. 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 28. 02. 2019, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE KËSHILLIT TË
BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR VARREZA NË FSHATIN RUBOFÇ

Neni 1

Me këtë vendim, ipet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh pronat komunale, Këshilli i Bashkësisë Islame në Lipjan, si në vijim:

1. Parcela kadastrale P-71409068-00756-0 në vendin e quajtur "Drum çeramdnica" me kulturë arë e kl.3-të me sipërfaqe prej 3517m² Zona kadastrale Rubofç, P.Sh. e Kuvendit Komunal Lipjan.

2. Parcela kadastrale P-71409068-00757-0 në vendin e quajtur "Drum" me kulturë jo Pjellore me sipërfaqe prej 4976 m² Zona kadastrale Rubofç, P.Sh. e Kuvendit Komunal Lipjan.

Neni 2

Pronat komunale siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi ipen në shfrytëzim me destinim për varreza në fshatin Rubofç dhe nuk mund të shfrytëzohen për qëllime tjera.

Neni 3

Me këtë Vendim obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e regjistrimit, KK Lipjan shfrytëzues Këshilli i Bashkësisë Islame në Lipjan me destinim për varreza, siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronësoro-juridik, Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ojeodezi dhe Kadmestër dhe Drejtorati për Shërbime Publike.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 463-44826
Lipjan, më 04. 03. 2019

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN





Pranimi me: Gjykatore:	19.04.2019
Emri Emri:	1-020-27008
Emri Emri:	
Emri Emri:	

241/16
18.04.2019

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
Ce:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Adijana Hodžić, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal Rozafa Ukinera, Sekretare e Përgjithshme
Nga:	Venera Cerçini, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave, MAPL
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Lipjanit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Pushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 15Nr.463-14826, për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për varreza në fshatin Rubofc.
I miratuar më datë: 28.02.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.03.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Pormullimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim
1.	Vendimi 15Nr.463-14826, për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për varreza në fshatin Rubovc.	Vendimi 15Nr.463-14826, i Kuvendit të Komunës së Lipjanit për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për varreza në fshatin Rubovc, nuk është në harmoni me Ligjin Nr.04/L-144 për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës përkatësisht nenit 10 pikë 1.4 e këtij ligji ku sqarohet se toka ipet në shfrytëzim për bashkësitë fetare për zhvillim të aktiviteteve fetare e jo edhe për varreza. Kuvendi i Komunës mund të marrë vendim të caktot lokacionin për varreza në fshatin Rubovc ashtu siç kërkohet nga bashkësia Islame por jo të ipet në shfrytëzim.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Lipjanit që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

REPUBLIKA E-KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KOMUNA E LIPJANIT
ZYRA E KRYETARIJ
Avokatia publike komunale
1Nr.Zy.59/2019
Me 30.07.2019
Lipjan

C.nr.349/2019

GJYKATA THEMELORENE PRISHTINË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHËSHËM

PADITËSI : Haradin Tasholli nga Gadimja e Ultë të cilin e përfaqëson avokati Sabri Kryeziu nga Lipjani

E PADITURA : Komuna e Lipjanit të cilën me autorizim e përfaqëson apk. Fatime Mustafa

ÇËSHTJA JURIDIKE: Vërtetim Pronësie

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan ma ka dërguar padinë së bashku me Aktvendimin C.nr.349/2019 në emër të paditësit Haradin Tasholli nga Gadimja e Ultë të cilin e përfaqëson avokati Sabri Kryeziu nga Lipjani e cila ka të bëjë me vërtetim pronësie, e paditura para mbajtjes së seancës gjyqësore në afat ligjor ushtron këtë:

PËRGJEGJE NË PADI

E paditura pas marrjes së padisë si dhe aktvendimin me numër C.nr.349/2019 ka verifikuar çështjet e cekura në padi dhe ka konstatuar se për ngastrën kadastrale është udhëhequr procedura e shpronësimit në mes të Raif Beqir Tashollit nga Gadimja e Ultë dhe ish Komunës së Lipjanit e që dëshmohej me aktvendimin 09.nr.817-465 të dt.06.05.1985 në të cilin aktvendim thuhet se paditësit i është shpronësuar ngastra kadastrale me nr.756 me kulturë arë e klasit të tret në vendin e quajtur „Drum” në sipërfaqe prej 0.35.17.ha në ŽK Rubovc me qëllim të zgjerimit të varrezave islame në fshatin Rubovc dhe në arsyetim të këtij vendimi thuhet se mjetet janë të siguruara për shpronësim qka do të thotë se paditësi i është kompensuar paluajtshmëria e shpronësuar sepse nuk ekziston as një mundësi ligjore që pa dokument të plotfuqishëm si aktvendim, marrëveshje apo kontratë mbi ndërrimin e patundshmërisë që të bëhet bartja në emër të komunës gjegjësisht të paditurës përndaj kjo çështje ka përfunduar qysh në vitin 1990, nga se sipas procesverbalit të dt.19.11.1990 i

C.nr.349/19

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË LIPJAN

Për:

Gjykatësin: Isa Gashi

Paditës: Haradin Tasholli nga fshati Gadime e Ultë K.Lipjan, të cilin me autorizim e përfaqëson Sabri Kryeziu avokat në Lipjan, rr. "Mbreti Zog" nr.5.
Të paditur: 1.Komuna e Lipjanit dhe 2.Bashkësia Islame në Lipjan.

Për shkak të vërtetimit të pronësisë.

PARASHTRESË E PALËS PADITËSE

Me të cilën e njoftojmë gjykatën që padia e paditësit të trajtohet si propozim për caktimin e kompensimit për tokën e shpronësuar.

Me padinë e paraqitur, paditësi, e ka bërë të besueshme për gjykatën faktin se parc.kad.nr.756, në sipërfaqe prej 3517 m2 në ZK.Rubovc, është shpronësuar nga Komuna e Lipjanit me aktvendim Nr.817-465 të dt.06.05.1985, gjithashtu e ka bërë të besueshme se sipas këtij aktvendimi kjo paluajtshmeri është regjistruar në emër të Komunës së Lipjanit, e njëjta nuk është kompensuar nga Komuna e Lipjanit, tani paditësi si dhe babai i tij para tij nuk janë gjveshur nga posedimi, dhe shpronësimi nuk është realizuar.

Me anë të kësaj parashtrese gjykatës i³ propozojmë që padinë e paditësit ta konsideroj si propozim për caktimin e kompensimit për tokën e shpronësuar, dhe në bazë të kësaj tani e tutje palë në procedurë janë:

Propozues: Haradin Tasholli nga fshati Gadime e Ultë K.Lipjan, të cilin me autorizim e përfaqëson Sabri Kryeziu avokat në Lipjan, rr. "Mbreti Zog" nr.5.

Kundërpropozuese: Komuna e Lipjanit.

Për ta vlerësuar vlerën e paluajtshmerisë së shpronësuar, gjykatës i propozojmë që të nxjerrë provën me caktim të ekspertit gjyqësor për vlerësim të paluajtshmerive, me të cilën ekspertizë do të vlerësohet në vlerë materiale paluajtshmeria e shpronësuar.

Për eksproprihimin e kryer në vitin 1985, Ligj material ka qenë Ligji për Eksproprihim (Gaz. Zyr. e KSAK 21/78), me ndryshime dhe plotësime të mëvonshme, kurse tani bazë juridike për vendosjen sipas propozimit është Ligji për Shpronësim e Pronës së Paluajtshme i Republikës së Kosovës, i cili gjen zbatim sipas nenit 40 të këtij ligji në pjesën e dispozitave kalimtare.

Propozuesi i propozon gjykatës që pasi ta pranojë propozimin, ta bëjë shqyrtimin paraprak të tij, të pret afatin prej 30 ditëve që kundërpropozuesja – Komuna e Lipjanit, ta dorëzojë përgjigjen sipas nenit 36 par.5 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme në gjykatë dhe në bazë të nenit 217 dhe 218 par.1 të Ligjit të Procedurës Jokontestimore, ta caktoj seancën gjyqësore, ku pas nxjertjes dhe administrimit të

provave të propozuara nga propozuesi dhe provave eventuale që do të nxjerrën sipas detyrës zyrtare, Gjykata të nxjerrë këtë:

AKTVENDIM

I.CAKTOHET kompensimi për eksproprijimin e parc.kad.nr.756 në sipërfaqe prej 3517 m2, e cila gjendet në ZK.Rubovc dhe

II.DETYROHET Komuna e Lipjanit që propozuesit Haradin Tasholli nga fshati Gadime e Ultë K.Lipjan, për marrjen e paluajtshmerisë nga par. I i këtij aktvendimi t'ia kompensoj shumën aq sa do të llogaritet me ekspert gjyqësor për vlerësim të paluajtshmerisë, me kamatë vjetore prej 7% duke filluar nga data 09.10.2019 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës që do të llogariten sipas regjistrit përfundimtar, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi me kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Me dt.09.10.2019
Lipjan

I autorizuari i paditësit
Av.Sabri Kryeziu